

NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,
DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#85

Takimi i Pesëmbëdhjetë vjetor ndërkombëtar i Institutit Alb-Shkenca



Takimi i Pesëmbëdhjetë vjetor ndërkombëtar i Institutit Alb-Shkenca
Prishtinë, 20 - 22 nëntor 2020


Instituti ALB-SHKENCA në bashkëpunim me Universitetin "Hasan Prishtina" të Prishtinës dhe me përkrahjen e Ministrit të Drejtësisë të Republikës së Kosovës organizon online në datat 20 – 21 nëntor 2020 "Takimin XV Vjetor Ndërkombëtar të Institutit ALB-SHKENCA". Tema e këtij takimi është "Pandemia dhe përballimi i efekteve të saj nga shoqëria jonë". Z. Pandeli Majko, Ministër i Shtetit për Diasporën mbajti në këtë takim fjalën e tij përshëndetëse ku theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me Institutin ALB-SHKENCA. Takimi është i organizuar në panele dhe konferenca shkencore ku pjesë e diskutimeve do të jenë dhe përfaqësues të diasporës shqiptare nga vende të ndryshme si SHBA, Kanada, Norvegji, Zvicër etj.



Vota e Diasporës Shqiptare

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

"Diaspora Flet 2020"/ Ministri Majko: Diaspora po kthehet nga sasi në cilësi



Nisi punimet konferenca "Diaspora Flet 2020", e cila për shkak të kushteve të pandemisë këtë vit mbahet online. Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko mori pjesë në panelin e diskutimit mbi përfaqësimin politik të Diasporës në shtetin amë. Gjatë fjalës së tij ministri Majko tha se sot Diaspora jo vetëm në Shqipëri po gjithë hapësirën shqiptare nga sasi po kthehet në cilësi duke u shprehur se ka nisur numërimi mbrapsht për realizimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë vendit. Konferenca "Diaspora Flet 2020" do të zgjasë tri ditë, 19-21 nëntor dhe synon të lidhë profesionistë të industrisë, biznese, komunitete, aktivistë dhe ekspertë nga e gjithë bota për të reflektuar mbi angazhimin e diasporës shqiptare në 20 vitet e fundit dhe për të eksploruar dhe reflektuar mbi rolin e saj në 20 vitet e ardhshme. Konferenca e këtij viti është ndërtuar rreth temës "GlobAL2020: Lidhu. Krijë. Bashkëpunë" që synon të eksplorojë mënyra në të cilat shqiptarët në të gjithë botën mund të ndikojnë pozitivisht dhe forcojnë bashkëpunimin ndërkombëtar, të kontribuojnë në rritjen e komuniteteve të diasporës dhe të bëjnë ndryshime domethënëse në jetën e atyre që jetojnë në vendet e origjinës.



Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës

Kjo është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionet e ndryshme në Diasporë

rrjetiprofesionisteve.al

1-vjetori i Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare erdhi ndryshe



Me qindra pjesëmarrës virtual nga vende të ndryshme të botës ndoqën këtë event nëpërmjet platformës zoom. Aktiviteti u hap me fjalën e kryetarit të Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare z. Ardian Lekaj, i cili falenderoi gjithë pjesëmarrësit që u bashkuan për të kujtuar këtë 1 vjetor të Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare. Në fjalën e tij përshëndetëse z. Lekaj surprizoi me dorëzimin e çmimit "Vizioni i Diasporës" drejtuar ministrit të Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko, për të vlerësuar kontributin e tij në hedhjen e themeleve të shëndosha dhe vizionin e bashkëpunimit të diasporës me vendin e origjinës. Në fjalën e tij përshëndetëse ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko, falenderoi z. Lekaj për vlerësimin dhe ftesën në 1-vjetorin e Dhomës së Biznesit të Diasporës. "Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare është një nga projektet më ambicioze që kemi nxitur në këtë periudhë dhe në një vit i ka dhënë sinjalet se është një strukturë serioze. Uroj Dhomën e Biznesit të Diasporës Shqiptare për 1- vjetorin duke mos u zgjatur me fjalë të tepërta në pozitën e të bërë politikën e ditës dhe vetëm kaq. "Ju jeni më shumë se politika e ditës"

Qendra e Botimeve për Diasporën marrëveshje bashkëpunimi mes Fakultetit të Gjuhëve të Huaja




U firmos marrëveshja e bashkëpunimit mes Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën. Qendra e Botimeve për Diasporën dhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit mes dy institucioneve për shkëmbimin e eksperiencës dhe hartimin, seleksionimin, përshtatjen, përmirësimin e teksteve shkollore dhe literaturës plotësuese për mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë, në kuadër të programit të botimeve dygjuhëshe të ndërmarrë nga Qendra e Botimeve për Diasporën. Projekti i parë që Qendra e Botimeve për Diasporën do të realizojë në bashkëpunim me Fakultetin e Gjuhëve të Huaja është mbikqyrja e përgatitjes së botimit dygjuhësh të "Regjimeve të mocme shqiptare" të Mitrush Kutelit në gjuhët: shqip-anglisht, shqip-frëngjisht, shqip-greqisht, shqip-italisht, shqip-gjermanisht. Drejtuesit e dy institucioneve, dekani i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, prof. Artur Sula dhe Drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, dr. Mimoza Hysa u shprehën të gatshëm për bashkëpunim dhe për mbështetje të ndërsjellë të projekteve dhe veprimtarive në të ardhmen.

Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"




FSHZHD organizoi Forumin Virtual "Kontributi i të Rinjve Shqiptarë në Diasporë"



Forumi virtual i organizuar nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, bëri bashkë në një takim të rinjve shqiptarë në Diasporë. Takimi u zhvillua virtualisht për shkak të kushteve të krijuara nga COVID-19. Nëpërmjet këtij eventi u synua krijimi i një ure komunikimi midis të rinjve shqiptarë, si dhe krijimi i një metodologjie bashkëpunimi bazuar në idetë dhe praktikatat më të mira të fituara në Diasporë. Në këtë event, të gjithë pjesëmarrësit patën mundësinë të ndajnë eksperiencat e formimit akademik, të jepnin sugjerimet e tyre në lidhje me mënyrat e përfshirjes përmes kontributit të tyre në zhvillimin socio-ekonomik të vendit të origjinës dhe vazhdimësisë së marrëdhënieve të bashkëpunimit midis të rinjve shqiptarë në Diasporë dhe Shqipëri. Në forum u prezantuan dhe dy platformat "Rrjeti i Profesionistëve në Diasporë" dhe "Digitalizimi i Veprave Shqiptare", ndërsa nga pjesëmarrësit u dhanë shembuj konkret të bashkëpunimeve të suksesshme me Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)

Botimi dygjuhësh shqip-anglisht "Libri i xhunglës" / "Tre derrkucët", falas nga QBD



"Libri i xhunglës" dhe "Tre derrkucët", dy përralla mjaft të dashura për fëmijët, pjesë e serisë "Klasikët Dygjuhësh" – projekt i Qendrës së Botimeve për Diasporën, flasin shqip dhe anglisht. "Libri i xhunglës", është një përmbledhje tregimesh shkruar nga autori anglez Joseph Rudyard Kipling, që rrëfijnë për aventurat e Moglit të vogël të braktisur në pyll dhe të rritur nga një tufë ujqish. Autori e shkroi librin për vajzën e tij 6-vjeçare dhe fillimisht e botoi në revista më 1893. "Tre derrkucët" është një përrallë popullore e përfshirë në grupin e rrëfenjave ndërkombëtare, e cila për herë të parë u botua më 1840. Libri i sjellë në shqip nga Parid Teferiçi është i pajisur me ilustrime shumë të këndshme, ka një tekst të thjeshtë dhe me fjalët më të përdorshme që lehtësojnë mësimin e gjuhës në mënyrë argëtuese. Libri dygjuhësh shqip dhe anglisht "Libri i xhunglës" dhe "Tre derrkucët", vjen falas për fëmijët shqiptarë të Diasporës dhe falas në versionin online për të gjithë.

Qendra e Botimeve për Diasporën promovon gjuhën shqipe në Diasporë



Qendra e Botimeve për Diasporën ju fton të bëheni pjesë e promovimit të gjuhës shqipe në Diasporë gjatë Javës së Alfabetit në datat 14 nëntor – 22 nëntor. Përgjatë këtyre ditëve, në të cilat është zhvilluar Kongresi që përcaktoi alfabetin që do të përdorej për gjuhën shqipe, do të sjellim disa video nën logon QMDO SHQIP. Studuesi dhe shkrimtari shqiptar me banim në Itali, Ardian Ndreca, pjesë e projektit të Qendrës së Botimeve për Diasporën për promovimin e gjuhës shqipe. MËSO SHQIP: Të gjithë bashkë për gjuhën shqipe!

KKD / Takim online me Deputetin e Bundestagut gjerman z. Peter Beyer



Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës zhvilluan një takim online me z. Peter Beyer, Deputet i Bundestagut gjerman dhe raportues i Këshillit të Evropës për Kosovën. Takimin e hapit anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës, si dhe Kryetari i Nderit i Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare, z. Lazim Destani, duke vijuar me një prezantim mbi punën dhe aktivitetet e Këshillit nga kryetari, z. Mark Gjonaj. Në takim u diskutuan mbi çështjet lidhur me liberalizimin e visave për Kosovën, situatën aktuale në ballkan si dhe mundësinë e shfrytëzimit të projekteve nga Bashkimi Evropian për një zhvillim ekonomik në rajon.